

ORGANET E SISTEMIT TË DREJTËSISË

Reforma në Drejtësi, një nga reformat më të thella ligjore dhe institucionale të dy dekadave të fundit, ka transformuar sistemin e drejtësisë.



Risitë e Reformës

- Krijimi i organeve të reja për administrimin e drejtësisë dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Ndryshimi i mënyrës së emërimit të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë;
- Zgjerimi i juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese;
- Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve = procesi i Vetting-ut.

Impakti i reformës tek qytetari

- Drejtësi e paanshme, e pavarur, e përgjegjshme dhe efektive;
- Gjyqtarë dhe prokurorë të pastër = përjashtimi nga sistemi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të korruptuar;
- Barazia e të gjithë qytetarëve para ligjit;
- Vendosja e detyrave dhe mbikëqyrja e veprimtarisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- Mundësia e qytetarëve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të garantuar zbatimin e të drejtave të tyre kushtetuese.



Organet e reja të Drejtësisë

- Këshilli i Emërimeve në Drejtësi - KED;
- Këshilli i Lartë Gjyqësor - KLGJ;
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë - KLP;
- Inspektori i Lartë i Drejtësisë - ILD
- Organet e Vetting-ut:
 - Komisioni i Pavarur i Kualifikimit - KPK;
 - Komisioni i Posaçëm i Apelimit - KPA.



Si mund t'i drejtohet qytetari këtyre organeve?



- Ankim Kushtetues Individual drejtuar Gjykatës Kushtetuese = për garantimin e mbrojtjes së të drejtave kushtetuese;
- Ankesë me shkrim drejtuar ILD-së = për hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorë të të gjitha niveleve;
- Qytetarët pjesëmarrës në procesin e Vetting-ut = ankesa drejtuar KPK-së dhe KPA-së për denoncimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve që nuk plotësojnë kriteret e kualifikimit.

